



Psikologjia evolucionare si “dogmë” e ateizmit

Description

David Berlinski

Fragment i shkëputur nga: David Berlinski, *The Devil's Delusion: Atheism and Its Scientific Pretension* (New York: Basic Books, 2009), 137-155.

Ideja se njerëzit janë pajisur me fuqi dhe cilësi që nuk gjenden askund tjetër në mbretërinë shtazore – apo në univers, për aq sa ne dimë – buron nga një imperativi thjeshtë: *Thjesht hidh vështrimin përçark*. Është një imperativ që i mbijeton ftesës për konsideruar vëllazërisht majmunët e mëdhenj. Majmunët, fundja fundit, rrinë pas hekurave të kafazëve të tyre, kurse ne jo. Të etur që eksperimentet të fillojnë, ata presin me padurim që t'u shërbehet ushqim. Duket se padurimin e kanë vetëm për ushqimin. Mbas viteve të eksperimenteve ndëshkuese, pak prej tyre u janë mësuar rudimentet e sistemeve të ndryshme primitive të simboleve. Kur u jepet dhuntia e gjuhës, ata thjesht s'kanë asgjë për të thënë. Kur dy majmunë talentetakohen, ata vringëlljnë shenjat para syve të njëri tjetrit.

Pritet diç më tepër, por rrallëherë shohim diç më tepër. Eksperimentet e kryera nga Dorothy Cheney and Robert Seyfarth – dhe ato janë të shkëlqyera – tregojnë se njëlloj si gjitarët e tjerë, babuinëtkanë një botë të brendshme të pasur, diçka kjo që vetëm intelektualët hijerëndë të psikologjisë bihejvioriste mund ta kishin vënë në dyshim. Strukturat sociale të majmunëshpeshherë janë të ndërlikuara. Shimpanzetë, bonobot, dhe gorillat arsyetojnë; ata bëjnë plane; kanë preferenca; janë dinakë; kanë pasione dhe dëshira; dhe vujanë. Do të shtoja se e njëjta gjë është e vërtetë për macet. Në shumëçka prej kësaj, ne shohim veten. Por përveç asaj që e kemi të përbashkët me majmunët, ne nuk kemi asgjë tjetër të përbashkët, dhe ndërkohë që ngjashmëritë janë interesante, diferencat janë ku e ku më të thella.

Në qoftë se njerëzit janë sikurse njerëzit mendojnë se janë, atëherë fitojnë peshë idetë fetare në lidhje me atë *çfarë* ata janë. Këto ide janë të lashta. Kanë lindur spontanisht në çdo kulturë. Burrave e grave ato u janë dukur konkluzione të qarta që mund të nxirreshin nga kjo hedhje e vështrimit përçark. Një sasi e stërmadhe e përpjekjeve intelektuale është investuar në të bindurit e burrave dhe grave që të mos vështrojnë përçark. “Ideja se mendjet njerëzore janë produkt i evolucionit është “fakt i padiskutueshëm”.” Kështu shkruan revista *Nature* në një editorial të sajën. Që të gjithë ta kuptojmë siç

duhet, *Nature* e shpreh edhe njëherë: “Me të gjithë respektin për ndjeshmëritë e njerëzve fetarë, ideja se njeriu u krijua sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, mund të flakët tutje pa asnjë mëdyshje.”

Ata të cilët nuk janë të gatshëm që t'i flakin tutje këto ndjeshmëri, ka konkluduar komuniteti shkencor, janë të pllakosur nga një formë e mosmirënjohjes intelektuale.

E habitshme se sa e përhapur është mosmirënjohja në të vërtetë.

Alfred Wallace: Një mospajtim bazik

Alfred Wallace krijoi, së bashku me Çarls Darwinin, teorinë moderne të evolucionit. Ai është lënë padrejtësisht në hije nga historia, ndoshta për shkak se pak kohë mbasi konceptoi teorinë e tij, ai filloi të kishte dyshime mbi origjinën e saj. Edhe Darvini gjithashtu kishte dyshimet e tij. Çdokujt që lexon *Mbi Origjinën e Llojeve* nuk mund t'i shpëtojë ankthi moral që spikat aty. Por dyshimet e Darwinit lindën për shkak se, duke menduar pasojat e saj, ai druante se teoria e tij mund të ishte e vërtetë; në rastin e Wallace, që e kundërta. Duke menduar pasojat e saj, ai kishte dyshime se teoria e tij mund të ishte e rreme.

Në një ese me mjaft interes botuar në vitin 1896 dhe të titulluar “Sir Charles Lyell mbi mjediset gjeologjike dhe origjinën e llojeve”, Wallace konturoi kuptimin e tij se evolucioni ishte joadekuat për të shpjeguar tipare të caktuara e të qarta të racës njerëzore. Eseja ka një rëndësi të dorës së parë. Ajo shënjon një rënie të besimit nga ana e një biologu të ndjeshëm që më herët i qe përkushtuar ideve që ai vetë kishte prurë. I sigurtë për “karakteristikat tona fizike,” ai vërente se ato “nuk janë të shpjgueshme nga teoria e ndryshimit dhe mbijetesës së më të fortit.” Këtu përfshihet truri i njeriut, organet e të folurit dhe artikulimit, dora e njeriut, dhe forma e jashtme e njeriut, me qëndrimin drejt dhe ecjen mbi dy këmbë. Vetëm njerëzit arrijnë të rrotullojnë gishtin e madh dhe gishtin e unazës në atë që quhet kundërvënie ulnarenë mënyrë që të arrihet një kapje, një mbërthim, dhe një shkallë e përdredhjes, gjë që i është mohuar çdonjërit prej majmunëve të mëdhenj. Asnjë sendi tjetër në listën e Wallace nuk i është hequr viza në raport me të kuptuarin e saktë në mendimin evolucionar. Ajo çka mbetet është një fantazi në të cilën ecja me dy këmbë i mvishet një paraardhësi të palokalizueshëm që dëshironte të vështronte (apo përmjerte) mbi barërat e gjatë të savanës.

Argumentin sa i përket trupit të njeriut, Wallace e parashtroi sërish sa i takonte mendjes së njeriut. Aty argumenti merr forcë. A e kuptojmë vallë përse, ndër të gjitha kafshët, njerëzit janë të vetmit që kanë përfunduar gjuhën? Apo një sistem moral të rafinuar dhe delikat, apo artin, arkitekturën, muzikën, vallëzimin, apo matematikën? Kjo është një listë tej e mase e shkurtuar. I gjithë korpusi i literaturës dhe filozofisë Perëndimore është një komentari i zgjeruar mbi natyrën njerëzore, dhe përgjatë vazhdës së mbi katër mijë viteve, nuk i ka shterruar misteret e kësaj natyre. “Nuk mund të zbuloni dot caqet e frymës,” ka shkruar Herakliti, “madje as nëse shkëlqen në çdo rrugë. E tillë është thellësia e formës së saj.”

E megjithatë, Wallace vërejti se nuk ka një dallim të qartë ndërmjet fuqive mendore të njeriut më primitiv dhe të njeriut më të avancuar. I rritur në Angli dhe jo në Amazonën ekuatoriale, një fëmijë indigjen i një fisi gjahtarësh të kokave, i destinuar përndryshe për një jetë në rendje në xhungël, do të mësonte të fliste përsosur gjuhën angleze, dhe me diplomim nga Oksford apo Kembrixh do të kishte avantazhin e dyfishtë të botëkuptimit intelektual modern dhe të një trashëgimie etnike komercialisht të vlefshme. Ai mund të bëhet matematikan, ai mund të kuptojë në përsosmëri kodet mbizotëruese morale dhe sociale, dhe për aq sa thuhet, ai mund ta gjejë veten si komentator i BBC, duke shpjeguar

me kthejlltësinë më të madhe domethënien kulturore të gjuetisë së kokave, si dhe duke argumentuar në mbrojtje të saj.

Nga kjo rezulton, argumentonte Wallace, se aftësitë karakteristike njerëzore duhet të jenë detyrimisht latente te njeriu primitiv, dhe ekzistojnë disi si një dhunti e paçelur, duke qenë kështoj porta në një botë që njeriu primitiv nuk e zotëron dhe as nuk do ta njihte.

Por ideja se një specie biologjike mund të zotërojë fuqi latente nuk ka sens në terma të darvinizmit. Kjo nënkupton doktrinën e përparësitë evolucionare janë dhënë paraprakisht dhe shumë kohë më parë; ajo bie ndesh me parimin darvinian se gjenet e padobishme u nënshtrohen trysnisë së seleksionimit negativ dhe, rrjedhimisht, duhet ta gjejnë veten të mpakura në rërën e kohës.

Wallace pikasi një konflikt të dukshëm midis teorisë së tij dhe atyre çka atij i dukeshin si fakte të padyshimta në lidhje me soliditetin dhe pandryshueshmërinë e natyrës njerëzore.

Ky konflikt vijon edhe sot; ende nuk është zgjidhur.

Ajo çfarë askush nuk e vë në dyshim

Askush nuk e vë në dyshim se njerëzit që jetojnë tani janë të lidhur me njerëzit që kanë jetuar mijëra vjet më parë. Po të shohim vizatimet në shpellat paleolite kuptojmë se artet grafike nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim rrënjësor këto dymbëdhjetë mijë vjet. Dhe askush nuk e vë në dyshim se njerëzit janë të lidhur me pjesën tjetër të mbretërisë shtazore.

Është goxha më e vështirë që të marrësh ajo çka askush nuk e vë në dyshim dhe ta modelosh në një mbrojtje efikase të tezës që njerëzit nuk janë *asgjë tjetër përpos* historik i gjallë i një procesi të zgjeruar evolucionar. Kjo kërkon një angazhim që është i disiplinuar drejt një pikëpamjeje – sado lirisht e interpretuar – që nuk i detyrohet shkencave për asgjë, dhe çuditërisht fare pak evidencave.

Pikërisht për këtë arsye – asnjë fije shkencë, pak evidenca – lidhja midis njerëzve dhe majmunëve është promovuar në kulturën bashkëkohore si virtyt moral, por dhe si fakt zoologjik. Ajo funksionon si gardh kundër besimit fetar, dhe si e tillë ajo avancohet me zell. Afirmimi se në themel njerëzit janë të ndryshëm nga majmunët cilësohet gjerësisht një defekt i paragjykimit ose një ngritje në qiell e kotësive. “Shimpanzetë dhe gorillat prej kohësh janë fushëbeteja e punës tonë kërkimore për unikalitet,” ka vërejtur Stephen Jay Gould, “sepse në qoftë se ne do të mund të përcaktonim një dallim të paekuivok – të llojit e jo të shkallës – ndërmjet nesh dhe të afërmeve tanë më të ngushtë, ne mund të kishim në dorë justifikimin kahmot të kërkuar për arrogancën tonë kozmike.”

Në gjurmët e Stephen Jay Gould, “zëri autentik” i të cilit i duket i parezistueshëm, Christopher Hitchens mbështet Mjeshttrin dhe deklarohe kundër arrogancës kozmike. Edhe unë mund të jem fare mirë mbështetësi i fundit i atij zëri, në fund të fundit. “Në qoftë se evolucionet që nga periudha kambriane mund të regjistroheshin dhe të “përsëriteshin”, shkruan Hitchens, “dhe kasete do të luhej sërish, ai [Gould] përcaktoi se nuk kishte asnjë siguri që [jeta] do të rezultonte njëllë.” Duke mos patur akses në kasetën e jetës, Gould, sigurisht, nuk përcaktoi asnjë gjë të tillë; unë po sjell në kujtesë skenarin e historisë sa për sport, *pour le sport*. Dhe çfarë sporti pale, duke qenë se përmban vetëm kremtimin e një tautologjie kristal të qartë. Sikur të mos kishte mbijetuar një vertebror i hershëm me emrin pakaia, të mbijetuarit e tij, raporton Hitchens i mrekulluar, nuk do të kishin mbijetuar. Vështirë se ka arrogancë më rigoroze se kjo. Ose më pak interesante. Mendimet e Hitchens do të më ishin dukur edhe më të

kënaqëshme në sikur ai të mos i kishte zgjeruar ato për të përfshirë dinamikën jolineare dhe parimin e papërcaktueshmërisë të Hajzenbergut, tema këto që ai në marrëzinë e tij e tund si një gjethe palme për të bërë fresk.

Kur vjen puna te majmunët, argumenti është kaq i pasigurtë saqë duhet bërë me garancinë që vjen nga pohimi i një absurditeti. Kur shkruan për “majmunin brenda nesh”, Frans de Waal është i preokupuar që të demonstrojë “sa ngjashmëri të madhe kanë majmunët me ne dhe sa shumë u ngjajmë ne atyre.”

Sa shumë, pra, u ngjajmë ne atyre, apo ata ne? Mos! Vërtet?! Përgjigja e saktë, sigurisht, është se ndonëse ne u ngjajmë majmunëve në disa mënyrë, ne megjithatë jemi mjaft të ndryshëm, dhe ne jemi të ndryshëm në mënyra që kanë një rëndësi të madhe biologjike dhe morale. Në qoftë se kjo është përgjigja e duhur, ajo nuk është një përgjigje që de Waal i propozohet që ta përkrahë. “Në qoftë se një jashtëtokësor do të vizitonte tokën,” shkruan de Waal, “ai do ta kishte të vështirë të shikonte pjesën më të madhe të dallimeve që ekzistojnë ndërmjet nesh dhe majmunëve.”

Supozoj se në qoftë se një peshk do ta këqyrte me maturi këtë çështje, ai do ta kishte të vështirë që të përcaktonte dallimet midis Al Gore-it dhe një balene të bardhë (e njohur si kashaloti sh.p.). Të dy janë të mëdhenj dhe njëri prej tyre ka formë aereodinamike. Kjo është ndoshta arsyeja përse peshqit nuk konsultohen mbi çështje të rëndësishme të taksonomisë. Apo për gjithçka tjetër.

Me dëshirën për një demonstrim më të hollësishëm (por jo më të qartë), si peshku ashtu dhe jashtëtokësori i de Waal-it do të përfitonin nga leximi i një artikulli seminal mbi këtë temë. Në artikullin e tyre në revistën *Science* në vitin 1975, M. C. King dhe A. C. Wilson ofruan për herë të parë një vlerësim të shkallës së ngjashmërisë ndërmjet genomit njerëzor dhe atij të shimpanzesë. King dhe Wilson pretendonin se njerëzit dhe shimpanzetë i kanë të njëjta pjesën më të madhe të genomëve të tyre përkatës, dhe shumë më tepër nga ç'mendohej asokohe.

Prej këndej del konkluzioni se në qoftë se genomët tanë përputhen kaq bukur, ne jemi detyrimisht majmunë.

Në seksionin e dytë të artikullit të tyre, King dhe Wilson përshkruajnë ndershmërisht mangësitë e kësaj ideje. Njerëzit dhe majmunët, vërejnë ata:

ndryshojnë shumë më tepër se sa llojet simotra në anatomi dhe se sa mënyra e jetesës. Ndonëse njerëzit dhe shimpanzetë janë mjaft të ngjashëm në strukturën e krahërorit dhe në krahë, ato ndryshojnë substancialisht jo vetëm në madhësinë e trurit por gjithashtu në anatominë e legenit, këmbës, dhe nofullave, si edhe në gjatësitë relative të gjymtyrëve dhe gishtërinjve. Gjithashtu njerëzit dhe shimpanzetë ndryshojnë në shumë aspekte të tjera anatomike, në masën që pothuajse secila kockë në trupin e një shimpanzeje është menjëherë e dallueshme në formë dhe madhësi nga homologja e saj njerëzore. Pa dyshim, me këto diferenca atonomike bashkëlidhen edhe diferenca madhore në qëndrim, në modusin e zhvendosjes, në metodat e sigurimit të ushqimit, dhe në mjetet e komunikimit. Për shkak të këtyre diferencave madhore në anatomi dhe në mënyrën e jetesës, biologët i vendosin këto dy lloje jo vetëm në gjini të ndryshme, por madje edhe në familje të veçanta.

Të gjitha këto kanë qenë evidente për Alfred Wallace. Apo për çdo student të anatomisë krahasimtare.

Më tutje, King dhe Wilson sugjeronin se diferencat morfologjike dhe në sjellje ndërmjet njerëzve dhe majmunëve, nëse nuk ishin për shkak të ndryshimeve midis genomëve të tyre, duhet të ishin si pasojë e ndryshimeve në sistemet rregullatore gjegjëse të genomëve. Këto janë sistemet që kontrollojnë veprimtarinë e gjeneve duke iu treguar gjeneve të ndryshme kur të komunikojnë me zë të lartë dhe kur të heshtin. Ato janë të një kompleksiteti mbresëlënës dhe janë të kuptuar pak, në mos vetëm për shkak se ato vetë lypin rregullim. Rregullimi i rendit më të lartë, nga ana tjetër, përmban kode të rendit më të lartë përtej kodit gjenetik. Kodet më pas kërkojnë që edhe ata vetë të kenë rregullim. Edhe qeliza më e thjeshtë përmban një kaskadë të ndërlikuar e të pafund të kontrollit e të koodrimit të një tipi që në botën fizike nuk është parë kurrë. Është krejtësisht e padëmshme që diferencat midis qenieve njerëzore dhe majmunëve t'u mvishen sistemeve të tyre rregullatore. Asgjë nuk dihet për shfaqjen e tyre evolucionare dhe ne e kemi të pamundur që t'i përshkruajmë ato me njëfarë qartësie.

Cilidoqoftë burimi i spikatjes së njeriut në natyrë, ekzistenca e saj është e evidente, dhe kur kjo mohohet shpërfillurazi, rezultati është një formë mjaft karakteristike e budallallëkut.

Kështu, Jonathan Gottshall kujton përvojat e tij gjatë leximit të *Iliadës* së Homerit ndërsa që nën ndikimin e tezës se, siç e formulon ai vetë, se “njerëzit janë majmunë”. Kjo është një tezë që ai ia atribuon librit të Desmond Morris me titullin *The Naked Ape*. “Por kësaj here,” sqaron Gottshall, “unë e përjetova Iliadën edhe si një dramë të majmunëve të zhveshur – duke u krekosur, duke pastruar parazitët me gishta, duke u përleshur dhe duke pëllitur fuqinë e tyre në një konkurrencë të ashpër për mbizotërim social, gra të bukura dhe burime materiale.” Në fakt, mbizotërimi social dhe burimet materiale nuk janë tamam pika kryesore. “Konkurrenca intensive ndërmjet majmunëve të mëdhenj, siç përshkruhet si nga Homerit ashtu dhe nga primatologët, shpeshherë reduktohet në një gjë të vetme: aksesin tek femrat!”

Fjala që bën ligjin në këtë citim është “reduktohet”, dhe si në aq shumë analiza të tilla, ajo çka është thelbësore nuk është ajo çka është distiluar, por ajo çka ka avulluar.

Pra, ka avulluar gjithçka që ngjall interes tek *Iliada*.

Në kulmin e betejës së Stalingradit, një toger i ri me Divizionin e 24-t Gjerman të Pancerave shkroi në ditarin e tij se Stalingradi “ditën, është një re vigane tymi verbues; është një furrë e paanë e ndezur nga pasqyrimi i flakëve. Dhe kur bie nata, njëra prej atyre netëve përvëluese e rënkuese e të përgjakshme, qentë zhyten në Vollgë dhe notojnë dëshpërimisht për të kapur bregun tjetër. Netët e Stalingradit janë të tmerrshme për ata. Kafshët e ndjejnë këtë ferr – as gurët më të pathyeshëm nuk i rezistojnë dot asaj; *vetëm njerëzit i rezistojnë*” (kursivet janë të miat).

A do të përfytyronte vallë ndokush që i lexon këto fjalë se rezistenca e njeriut është largazi e ngjashme me konkurrencën e vrullshme të majmunëve që janë të etur për t'u çiftuar dhe janë dukshëm të trazuar kur s'munden?

Kjo nënkupton një këshillë të qartë për pak përlësi. Është një këshillë që mund t'i drejtohet me mjaft dobi biologëve që janë tej mase të shqetësuar për arrogancën kozmike. Përpara se të flakim tutje me shpërfillje “idenë se njeriu u krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë”, le të shqyrtojmë pikë pari idetë që propozohen të mbrohen në vend të saj.

Në qoftë se nuk janë të mira, përse t'i mbrojmë?

Dhe ato s'janë hiç të mira. Pra, përse i mbrojnë?

Favoritja

Në vitet 1970-të Edward Wilson botoi *Sociobiology* kurse Richard Dawkins botoi *The Selfish Gene* (*Gjeni egoist*). Që nga ajo kohë, psikologjia evolucionare është bërë një favorite e epokës bashkëkohore. Rrëfenja që ajo avancon është një rrëfenjë që ndodh krejtësisht benda llojit njerëzor. Nuk i zbatohet asnjë majmuni, sepse majmunët nuk na duhen.

Elementët bazë janë të thjeshtë dhe ato kanë strukturën e thjeshtëzuar të një përralle – dhe vërtet, filozofi David Stove e ka titulluar mësymjen e tij kundër psikologjisë evolucionare *Përralla Darwiniane* (*Darwinian Fairytales*). Tiparet domethënëse të psikologjisë njerëzore u shfaqën fillimisht gjatë epokës së paleolitit të vonë – e ashtuquajtura Epoka e Përshtatjes Evolucionare. Për arsye që askush nuk i ka specifikuar siç duhet, ndodhi atëherë që njerëzit shpikën strategjitë e tyre kundër-reaguese ndaj pasigurive të jetës – gjetja e ushqimit, mbijetesa, dhe bërja e “asaj punës”. Këto strategji buisin edhe sot e kësaj dite. Ato janë në thelb të personalitetit modern njerëzor. Ne jemi këta që jemi. Më pas, erdhi Epoka e Gjatë Ku Asgjë Nuk Ndodhi, ku mendja njerëzore moderne ruajti në strukturën dhe programet e saj vulën dalluese të asaj kohe kur njerëzit kaluan në savanah apo në pyje, duke bërë gjueti, duke u grumbulluar, dhe duke u riprodhuar me një gusto darviniste.

Ndonëse përmbajtja e tyre nuk është për t'u marrë parasysh, ndikimi i këtyre rrëfenjave është i pamasë. Teksa komentonte mbi reklamën negative në fushatat politike, Kathleen Hall Jamieson, drejtorja e Qendra së Politikës Publike Annenberg në Universitetin e Pensilvanisë, vërejtë se “duket se ka diçka të ngjashme me përcjellësat elektrikë tek njerëzit e cila u jep një vëmendje të posaçme informacioneve negative.” Më pas vjen një thënie që tanimë është bërë tipike: “Them se kemi të bëjmë me biologjinë evolucionare.” Fakti që nuk ka përcjellësa elektrikë te njerëzit, për shkak se ne s'jemi fare me përcjellësat, kapërcehet si krejt rastësore. Metafora në fjalë ka marrë një jetë krejt të vetën, dhe tanimë që po rron, është bërë e madhe.

Mbasi shpjegon reklamën negative, biologjia evolucionare shpjegon gjithashtu edhe luftën dhe agresivitetin mashkullor, ndjeshmërinë njerëzore ndaj bukurisë, thashethemet, parapëlqimin e periferisë për banim, dashurinë, altruizmin, martesën, xhelozinë, tradhëtinë bashkëshortore, egërsinë në timon, besimin fetar, frikën nga gjarpërinjtë, neverinë, djersitjen natën, infanticidin, dhe pse prindërit janë të dhënë pas fëmijëve të tyre. Ideja se sjellja njerëzore është “produkt i evolucionit”, siç e parashtron këtë çështje *Washington Post*, është tanimë më tepër se një teori, është një bindje *pop*. Bindja është kaq popullore sa që ajo madje mund t'i kundërvihet paturpësisht konvencioneve mbretëruese të korrektesës politike. Rezultati është një përplasje frymëzuese e klisheve. Në një artikull të botuar në *Psychology Today*, Alan S. Miller dhe Satoshi Kanazawa përshkruajnë ato çka ata i cilësojnë dhjetë të vërtetë politikisht jokorrekte në lidhje me natyrën njerëzore. Ata i cilësojnë këto të vërteta si *zbulime*, dhe kur përmbledhin gjënë e parë në listën e tyre ata raportojnë sikur t'u ishte plotësuar habia prej eksploratori – *Pa shiko, pa shiko çfarë ka këtu?!* – se “burrave u pëlqejnë bjondet bojallesha”. Në qoftë e kjo është një nga të vërtetat për natyrën njerëzore, atëherë ajo nuk paskësh qenë e fshehur fort mirë.

Dhe as nuk duket se kërkon ndonjë shpjegim përtej asaj çka është e qartë. Burrave u pëlqejnë bjondet bojallesha pasi ato janë bojallesha bjonde. Do shkoja dhe më tutje! Burrave duket se u pëlqejnë bojalleshat pavarësisht nga ngjyra e flokëve.

Çfarë nevojitet realisht më tepër?

Për Miller dhe Kanazawa, kërkesat e shkencës janë shumë më të konsiderueshme. Ajo çka ata lypin është një shpjegim *përtej* të qartës. *Aussitôt dit, aussitôt fait*, (u tha, u bë), siç thonë francezët. U tha, pa për të bërën, mbetet për t'u parë! Paraardhësit tanë miliona vite më parë, pohojnë ata, kanë qenë qartazi të preokupuar që të zbulonin gra të shëndetshme e të bukura, dhe në mungesë të aftësive të duhura gjinekologjike, nevoja i shtrëngonte ata që t'u kushtonin vëmendje karakteristikave të tyre seksuale dytësore. Prej këtu vjen dhe popullariteti i bojalleshave bjonde. Kjo temë ka qenë fokus i punës kërkimore përgjatë dekadave, ku psikologët kanë hulumtuar me një zell të patundur masën në të cilën bojalleshat bjonde janë bojallesha; madje, ka raste kur ata e kanë kryer punën kërkimore në klube të ndryshme striptizmi për të përcaktuar më saktë që bojalleshat janë në tërësi bjonde.

Të panevojshme sa i përket relevancës, këto ide si shpjegim nuk janë bindëse. Në qoftë se preferencat seksuale janë rrënjësore në epokën e vonë paleolite, burrat në mbarë botën duhet të ishin sot në kërkim të grave trupbledhura, me fundshpina të gjera, këmbë të fuqishme, me rezistencë të madhe ndaj dhimbjes, dhe një etje të mirëpritur për të rifilluar kërkimin e ushqimit menjëherë pas lindjes së foshnjave. Në tërësi, nuk është dokumentuar se i kërkojnë të tilla.

Sidoqoftë, pararadhësit tanë nuk janë këtu që t'i pyesim. Pretendimet e bëra në emër të tyre janë të paverifikueshme. Tekstura themelore që lidh epokën paleolite të vonë dhe epokën moderne është *gene pool*, apo hauzi i gjeneve. Ndryshimet në atë haur reflektojnë një proces dinamik në të cilin gjenet i nënshtrohen ndryshimit, dyfishohen, turrendrejt të ardhmes dhe shkartin, dhe, me anë të të gjitha rastësive të jetës, në çdo brezni i shërbejnë qëllimit të krijimit të një tjetër breznie. Janë pikërisht këto kondita fillestare të cilat përshkrimet popullore të evolucionit njerëzor nuk arrijnë t'i ofrojnë. Për ata gjuetarë dhe mbledhës, ne mund të themi vetëm se ata bënëin gjueti dhe se mblidhnin, dhe ne mund ta themi këtë vetëm për shkak se duket e vetëkuptueshme që ata nuk kishin se ç'të bënëin përveç kësaj. Hauzi i gjeneve që ata mishëronin nuk mund të rikuperohet.

Kësisoj, rrëfenja më e madhe e treguar nga psikologjia evolucionare është anekdotike. S'ka asnjë vlerë shkencore.

Më mirë të jemi të ndershëm me njëri tjetrin: S'ka asnjë lloj vlere!

Mendja e njeriut

Vetëm dje Frojdi e përshkruante mendjen njerëzore si një shtëpi të mbushur me fantazma. Ky përfytyrim ka një vlerë jetëgjatë, në mos, vetëm për shkak se në njëfarë rrafshi të gjithë ne na rrinë mbi krye si fantazma gjëra që ne nuk mund t'ua vëmë emrin dhe nuk i njohim. Sidoqoftë, mangësitë analitike të teorisë frojdiane janë të konsiderueshme, sepse ndonëse shtëpia frojdiane ishte me fantazma, Frojdi e kishte të pamundur të na thoshte se *kush* i vuri ato fantazma aty. Gjëra si idi, egoja, dhe superegoja funksiononin si karaktere në sistemin e Frojdit. Ato kishin nevoja, ato i bënë të ditura kërkesat e tyre, ishin mjeshtërore në të ndenjuri fshehur; dhe këto janë ndër atributet e mendjes së njeriut për të cilat kishte fillimisht nevojë për shpjegim.

Shtëpia e mbushur me fantazma në kohën tonë i ka hapur rrugë kompjuterit digjital. Argumenti vijon hap pas hapi. I pari hap përmban flakjen tutje të mendjes si një kategori e veçantë ontologjike. Mendja dhe truri, siç supozoi Dekarti?! Ky është dualizëm kartezian dhe është gjerësisht i hedhur poshtë nga filozofët. “Çdo aspekt i mendimit dhe emocionit,” ka argumentuar Steven Pinker në *How the Mind Works*, “është i rrënjësuar në strukturën dhe funksionin e trurit.” Kjo na tregon se ku është mendja duke na treguar se ku ka shkruar ajo. Ajo është e përpirë nga truri. Në qoftë se një njeri do të donte dinte drejtimin për diku, mjafton që të shtypë butonin që duhet në kafkën e tij:

Shtyp një: Mendja është truri

Se si mund të pozicionohet brenda trurit të njeriut nepsi për një haribo me luleshtrydhe, Pinker nuk e thotë. Ndoshta, këtu përfshihen neurone që u dediokohen xhelatinës? Pyetjen e kam me sinqeritet prej hulumtuesi.

Me mendjen të flakur tutje, Pinker-it i ngelet që të shpjegojë se si truri ndërmerr kaq shumë veprimtari që dikur ndërmerreshin nga mendja. Sikurse pritej, as kjo nuk është problem. Është kapaciteti i trurit për të përpunuar informacione, beson Pinker, ajo që “i lejon qenieve njerëzore të shohin, mendojnë, ndjejnë, zgjedhin dhe veprojnë.” Kompjuteri digjital është pikërisht një pajisje e projektuar për të përpunuar informacione. Nga kjo ne kuptojmë se si funksionon truri. E njëjta shtypje domethënëse e butonit mund të evokohet për herë të dytë.

Shtyp Dy: Truri është një kompjuter

Mes *Shtyp një* dhe *Shtyp dy*, mendja është ulur në pozitë (S’ka mendje!) dhe është shpjeguar (Kjo gjë s’është kompjuter!).

Çfarëdo që mund të thuhet në lidhje me mendimet e Steven Pinker në lidhje me mendjen e njeriut, atyre nuk u mungon forca dramatike.

Në vitin 1936, logjicieni britanik Alan Turing botoi të parin e artikujve të tij akademikë mbi komputabilitetin. Duke përdorur vetëm bojë, letër, dhe burimet e logjikës matematikore, Turing ia arriti që krijonte një makinë imagjinare që ishte e aftë të mishëronte një imitim mjaft të mprehtë dhe mjaft të sofistikuar të mendjes së njeriut.

E njohur si makina Turing, kjo pajisje kishte në dispozicion një shirit të ndarë në katrorë, dhe një kokë lexuese të vendosur mbi shiritit. Gjithashtu, ajo ka një numër të fundëm të simboleve fizike. Koka

lexuese mund të zërë njërin prej një numri të fundëm të gjendjeve të dallueshme fizike.

Dhe më pas, repertori i veprimit të saj është jashtëzakonisht i kufizuar. Një makinë Turing në radhë të parë mund të njohë simbole, një katror për çdo herë. Në radhë të dytë, ajo mund të printojë simbolet ose t'i fshijë ato nga katrori që po skanon. Dhe, në radhë të tretë, mund të ndryshojë gjendjen e saj të brendshme, dhe të lëvizë majtas apo djathtas katrorit që po skanon, nga një katror për çdo herë.

Nuk ka radhë të katërt. Pa një program, makina Turing nuk bën dot asgjë tjetër. Në fakt, e cilësuar thjesht si mekanizëm, makina Turing nuk mund të bëjë asnjë lloj gjëje, pasi gjëja në fjalë ekziston në atë botë tipike – e imja, sigurisht – në të cilën çdo gjë është e mundur, por ku nuk bëhet asgjë.

Ndonëse imagjinare në zanafillën e saj, makina Turing parapriu në mënyrë brilante realizimin e saj në materie, pasi idetë e Turing i dhanë hov kompjuterit modern.

Gradimi i kompjuterit nga një objekt imagjinar në një objekt material i shërben qëllimit të rikthimit të tij në botën që mund të kuptohet në terma të shkencave fizike. Si një pajisje fizike – thjesht një koleksion i qarqeve elektronike – kompjuteri digjital mund të përfaqësohet krejtësisht nga teoria e fushës elektromagnetike e Klerk Maksuellit. Dallimi ndërmjet një kompjuteri dhe programit të tij përsëritet në dallimin ndërmjet një sistemi fizik të rregulluar nga ligje të caktuara specifike dhe kondita e tij fillestare – gjendja nga e cila ai fillon. Këtu ne jemi rikthyer në botën e vazhdueshme dhe të pafundme në të cilën fizika matematikore e gjurmon evolucionin e objekteve lëndore duke lëvizur në kohë në kundërpërgjigje ndaj forcave të përjetshme të vetë natyrës.

Në qoftë diçka fitohet nga asimilimi i trurit në një pajisje komputuese, ka edhe diçka që humbet gjithashtu, dhe ky është pranimi se thellë-thellë çdonjëra prej këtyre metaforave është thellësisht e kufizuar. Njëfarë “fuqie për të ndryshuar gjërat,” ka thënë Albertus Magnus, “buit në frymën njerëzore”. Ekzistenca e kësaj fuqie vështirë se vihet në dyshim. Ajo është e evidente në çdo akt njerëzor në të cilën mendja imponohet mbi natyën duke i marrë objektet lëndore nga vendi i tyre i zakonshëm dhe duke i aranzhuar rishtazi ato, dhe kjo bëhet sërish e qartë sa herë që një njeri ndërvepron me një makinë. Teksa shkruante me një koncizitet tipik në veprën e tij *Principia*, Isak Njutoni vërente se “fuqia e dhe përdorimi i makinerive konsiston vetëm në një gjë: se duke pakësuar shpejtësinë ne mund të argumentojmë forcën, dhe anasjelltas.” Ndonëse analiza e Njutonit kufizohej në forcat mekanike, megjithatë argumenti i tij është i përgjithshëm. Një makinë është një objekt material, një *send*, dhe si i tillë kapaciteti i saj për të kryer punë përcaktohet nga forcat që rregullojnë natyrën e saj dhe nga konditat e saj fillestare. Përpara se një rrafsh i pjerrëttë mund të kryejë punë, ai duhet të jetë i *pjerrët*.

Edhe ato kushte fillestare duhet të shpjegohen, dhe bazuar në natyrën e gjërave, ato nuk mund të shpjegohen me vetë mekanizmin për shpjegimin e të cilit ato shërbejnë. Një rrafsh i pjerrët nuk bëhet *vetë* i pjerrët. Ky është pikërisht problemi me të cilin u përball Njutoni në *Principia*. Sistemi madhështor i botës që ai hartoi shpjegonte se përse orbita e planeteve duhet të jetë me seksione konike, por Njutoni e kishte të pamundur të shpjegonte konditat fillestare që ai vetë i kishte imponuar mbi sistemin e tij.

Ky model, së bashku me problemet e tij, përsëritet sa herë që në diskutim janë makineritë, dhe rikthehet me forcë sa herë që kompjuterët evokohen si modele për mendjen njerëzore.

Në qoftë se truri është kompjuter, atëherë vetë teza në lidhja me mendjen njerëzore duhet të jetë në fuqi qoftë kur ne diskutojmë mendjen njerëzore si një kompjuter digjital apo qoftë kur ne e

përshkruajmë mendjen njerëzore në terma të një pajisjeje që logjikisht është identike me një kompjuter digjital – një numëror, le të themi. Numërori është një gjë krejt e thjeshtë. Bërë prej druri, numërori përbëhet nga një numër telash të vënë në një kornizë dhe një numër i fundëm rruazash që lëvizin përgjatë telave. Megjithatë, një numëror i idealizuar ka pikërisht fuqinë e një makine Turing, dhe kështu si numërori ashtu dhe makina Turing shërbejnë si modele për një kompjuter digjital funksional. Me analogji në arsyetim, ato të dy shërbejnë si modele për mendjen njerëzore.

E megjithatë, teza se mendja njerëzore është një numëror duket dallueshëm më pak bindëse se teza që mendja njerëzore është kompjuter. Dhe për një arsye të dukshme: kjo është absurde. Ndërveprimi midis një njeriu dhe një makine të thjeshtë del më qartë në pah pikërisht kur gjërat reduktohen në vetitë e tyre bazike. Ky ndërveprim është i zhveshur, pasi një agjent njerëzor që merret me një numëror me të njëjtën prekje që ai mund ta përdorë në levë, pulexhë, apo një rrafsh të pjerrët.

Kur zbulohet se ndërveprimi është krejt i zhveshur, në pah gjithashtu del edhe një problem karakteristik. Ndërkohë që një numëror mund të përfaqësojë operacione të caktuara intelektuale njerëzore, të tilla si mbledhja apo zbritja, ai nuk mund të përfaqësojë konditën e tij fillestare. Sa i përket klientëve hundë-përpyjetë që sillen me shpërfillje, është arkëtarja kineze në hotelin Imperial Gardens ajo që e bën një gjë të tillë. Forca që ajo ushtron mbi numëror është muskulare, dhe kështu rrjedh nga kimia e trupit njerëzor, me këto shkaqe që përfundimisht zbrazen në oqeanin e madh të ndërveprimeve fizike energjia e të cilave liron dhe shtrëngon molekulat e mëdha të botës.

Asnjë zinxhir i njohur i shkaqeve nuk akomodon faktin e pavolitshëm se duke përcaktuar konditat fillestare të një makine të thjeshtë, një arkëtare kineze ka bërë të mundur një shpërndarje të re, të papritur dhe krejtësisht idiosinkratike të lëndës. Gjendja fillestare e çdo artefakti mekanik përfaqësohet nga ajo çka antropologja Mary Douglas e ka quajtur “lënda jashtë vendit”. Të shpjegosh edhe më të thjeshtin e veprimeve njerëzore, prekjen e thjeshtë që lëviz një rruazë druri në një tel, lypet që zinxhiri kauzal të gjurmohet së prapthi. Por kjo shpie vetëm në një mizëri shkaqesh, ku secili prej tyre ka zhvendosur objekte lëndore nga mjedisi i tyre i duhur, kështu që në fund misteri thjesht ndiqet deri në atë thellësi kur ai mund të injorohet pa asnjë merak.

Kësisoj, një zinxhir i shkaqeve fizike nuk është dukshëm i dobishëm në shpjegimin e asaj se si mendja njerëzor e imponon veten ndaj lëndës. Por as nuk ndihmon që të evokojë hipotezën se një tjetër numëror nevojitet për të fiksuar konditat fillestare të numërorit të parë. Në qoftë se çdo numëror kërkon një tjetër numëror, atëherë i është hapur rruga çmendurisë së regresit të pafundëm. Daniel Dennett, në *Brainstorms: Philosophical Essays on Mind and Psychology*, ka argumentuar se në qoftë se kompjuterëve regresivëu pakësohet kapaciteti, atëherë regresi mund të përfundojë në ndonjë pajisje të papërfillshme mekanike, që ai e cilësoi si “budallaqe”. Por në qoftë se ata kompjutera regresivë janë tejet të dendur për të funksionuar si modele të mendjes, si e bëjnë ata vallë atë që thuhet se bëjnë?

Dhe në qoftë se nuk e bëjnë, si kemi avancuar ne?

Nëse ne nuk jemi në gjendje të shpjegojmë se si funksionon mendja njerëzore as në terma të një vargu të shkaqeve fizike as në terma të një vargu të pajisve mekanike pafundësisht regresive, çfarë mbetet në këtë rast? Është përshkrimi i zakonshëm, mjaft i pasur, pafundësisht prekës i jetës mendore që pa hezitim ne ia zbatojmë veteve tona. Është një përshkrim sinqerisht magjik në natyrën e tij. Mendja njerëzore regjistron, reagon, dhe kundërpërgjigjet; ajo formon qëllime, koncepton probleme, dhe më pas, sikurse ka thënë ftohtë Aristoteli, ajo *vepron*.

Dhe në asgjë nga kjo nuk duket se bëjmë diçka që mund të shpjegohet apo shprehet në terma të asaj çka bën truri, apo asaj çka mund të bëjë çdo makineri.

“Mendja nuk është si asnjë cilësi tjetër e sistemeve fizike,” ka thënë me mjaft vend fizikani Erich Harth. “Nuk është thjesht se ne nuk i njohim mekanizmat që e shkaktojnë atë. E kemi të vështirë që të shohim se si ndonjë mekanizëm mund ta shkaktojë atë.”

Liqeni i dyshimit

Njëri prej kuriozitetëve lidhur me entuziasmin aktual për përshkrimet e ndryshme pseudo-shkencore lidhur me mendjen njerëzore është se thellë thellë ata që janë më të gatshëm për të promovuar premisat e saj janë më pak të gatshëm për të pranuar konkluzionet e saj.

Pavarësisht se çfarë mund të thonë shkencëtarët mbi ato rastet mjaft të shpeshta kur ata na këshillojnë pjesën tjetër prej nesh se çfarë të mendojmë, një gjë që ata nuk e thonë është se ata i besojnë asaj që na thonë të mendojmë. Herë herë rezultati është prekës. Kur i shkruante të vesë së mikut të tij të vjetër Michele Besso, Ajnshtajni vinte në dukje se ai “tani është larguar nga kjo botë e çuditshme pak përpara meje. Kjo nuk do të thotë asgjë. Njerëzit si ne, të cilët besojnë në fizikë, e dinë se dallimi ndërmjet të shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes është vetëm një iluzion që vijon me kryeneçësi.” Cilidoqoftë iluzioni në fjalë, pranoi Ajnshtajni me trishtim, ai është një iluzion që “pohohet me kryeneçësi”.

Shpeshherë, distanca mes asaj çka figurat shkencore përfaqësojnë dhe asaj çka ata besojnë përbën një ushtrim çuditërisht të suksesshëm në të gënjerit e vetes. Kur u botua për herë të parë, libri i Richard Dawkins *The Selfish Gene* (Gjeni Egoist) pushtoi krejtësisht botën intelektuale. Pati gjerësisht raportime mbi përvojat e konvertimit në gjirin e të rinjve. Akoma ka raportime të tilla. Ideja se ne të gjithë jemi “robotë të ngathët” të projektuar nga përzgjedhja natyrore për të avancur interesat e gjeneve tona është bërë një nga ato gjërat që besohen në masë pikërisht sepse gëzojnë besim në masë. Ky mister madje është kremtuar edhe në art. E promovuar fillimisht në Festivalin Shkencor të Kembrixhit, *Lifetime: Songs of Life & Evolution* është një dramë që ka për “mision të përhapë fjalën e mirë mbi evolucionin.” Aty gjen dedikime ndaj Richard Dawkins, dhe një këngë titullohet “Unë jam një gjen egoist dhe jam programuar që të mbijetojë”. Ndonëse s’e kam parë, jam i bindur se kjo përpjekje teatrale është e tmerrshme pa masë.

Ajo çka të lë pa mend në gjithë këtë është se askush s’i merr seriozisht ata që i marrin seriozisht gjenet egoiste. Richard Dawkins ka shkruar deri aty sa ka pohuar se ai, të paktën, nuk është nën kontrollin e gjeneve të tij. “Unë jam një oponent tejet i paepur i determinizmit gjenetik,” ka shkruar ai. Gjenet e tij nuk janë aq egoiste sa t’i thonë atij se çfarë duhet të bëjë. Kush e di çfarë mund të ndodhë në qoftë se ai u jep dorë të lirë atyre? Ai mund të ecë ngathtë, por në qoftë se kjo ndodh, ngathtësi mbetet nën

kontrollin e tij.

Jemi ne të tjerët të cilët duhet të vijojmë të ecim, sado ngathtë.

Konkluzioni më pak i mirëpritur i psikologjisë evolucionare është gjithashtu edhe më i dukshmi: në qoftë se psikologjia evolucionare është e vërtetë, ndonjë formë e determinizmit gjenetik mund të jetë e vërtetë po ashtu. Determinizmi gjenetik është thjesht teza sipas së cilës mendja njerëzore është shprehje e gjeneve të saj njerëzore. Vështirë se gjen një shkarje të ngjashme që të jetë racionalisht e mundur.

Psikologët do kundërshtojnë. Katedra është e tyrja. Ekziston mjedisi, thonë ata. Edhe ai luan një rol. Sigurisht, mjedisi ka qenë zëri i përjetshëm që ka folur kundër historikut në *Nutricion Vs. Natyrë et al.* Por për qëllimet tona, tanimë mjedisi mund të flaket tutje nga konsideratat e mëtejshme. Nëse mjedisi kontrollon si janë bërë njerëzit dhe si veprojnë ata, atëherë ata nuk kanë lindur në atë mënyrë; dhe nëse nuk kanë lindur në atë mënyrë, një shpjegim i mendjes së njeriut nuk mund të shprehet asesi në terma evolucionarë.

E si mund të jetë, vallë, ndryshe? Sipas pikëpamjeve të tanishme, është gjeni që përzgjidhet nga evolucioni, dhe nëse ne nuk jemi të kontrolluar nga gjenet tona, ne nuk kontrollohemi as nga evolucioni.

Nëse nuk kontrollohemi nga evolucioni, atëherë psikologjia *evolucionare* nuk ka asnjë relevancë në shpjegimin e prejardhjes apo natyrës së mendjes së njeriut.

Dhe nëse ajo nuk ka asnjë relevancë për prejardhjen dhe natyrën e mendjes së njeriut, përse promovohet ajo me kaq këmbëngulje, qoftë edhe për një grimë të jetës së saj apo tonës?

Fundja fundit, një teori e suksesshme evolucionare e mendjes së njeriut do të asgjësonte çdo pretendim që mund të bëjmë për llogari të lirisë njerëzore. Shkencat fizike nuk bëjnë shaka me determinizmin: ai është shpirti dhe mishi i metodës së tyre. Sikur kripërat e borit të kishin lirinë që të shpërfillnin identitetin e tyre, pretendimet e kimit do të dukeshin shumë më pak të qëlluara se sa ç'duken.

Kur Steven Pinker shkruan se “natyra nuk dikton atë çka duhet të pranojmë apo si duhet të jetojmë jetët tona,” ai po shpreh një besim – një besim pa dyshim të vërtetë – që është krejtësisht në mospërputhje me angazhimet e tij profesionale.

Në qoftë se burrat dhe gratë e zakonshme, si vetë Pinker, janë përsosmërisht të lirë për t'u thënë gjeneve të tyre “shkoni hidhuni në lumë”, përse t'i kushtojmë qoftë edhe një fije vëmendje psikologjisë evolucionare?

Përse t'i kushtojmë qoftë edhe një fije vëmendje Pinker-it?

Ose teoria në të cilën ai beson është e gabuar, ose ne nuk jemi të lirë që t'u themi gjeneve tona që të bëjnë diçka.

Në qoftë se teoria në fjalë është e gabuar, cila teori është e saktë?

Në qoftë se asnjë teori nuk është e saktë, atëherë si ka mundësi që “ideja se mendjet njerëzore janë produkt i evolucionit” të jetë “fakt i padiskutueshëm”?

Në qoftë se kjo ide *nuk është* fakt i padiskutueshëm, përse duhet ta fusim në sirtar “idenë se njeriu u krijua sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë”?

Këto hamendësime duhet të lejohen tanimë që të flaken tutje në një numër formulimesh kategorike:

Nuk ka *asnjë* arsye për t’i dhënë vëmendje Steven Pinker-it.

Ne *nuk* kemi një teori serioze shkencore që shpjegon kapacitetet dhe cilësitë e mendjes së njeriut.

Pretendimi se mendja e njeriut është produkt i evolucionit nuk është një fakt i padiskutueshëm. Madje, vështirë se mund të quhet koherent.

Ideja se njeriu u krijua sipas shëmbëlltyrës së Zotit *ngelet* siç ka qenë gjithnjë: dhe ajo ide është pozicioni instiktiv themelor i racës njerëzore.

Përktheu: Arjol Guni

Date Created

21/03/2021

Author

erasmusi